

Shtyhet thirrja për aplikime për bursa për studentët në Universitetin Saint Louis në Bruksel, në kuadër të Programit Erasmus +, për semestrin e dytë të vitit akademik 2020-2021.

Në kuadër të programit Erasmus + është shtyrë thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin Saint Louis në Bruksel, për semestrin e dytë për vitin akademik 2020-2021.

<https://www.usaintlouis.be/>

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve për studime;

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- Bachelor;

- Ph.D;

Kohëzgjatja e bursave:

- Bachelor (5 muaj);

- Ph.D (5 muaj);

Fushat e studimit:

- Marrëdhënie Ndërkombëtare;

- Shkenca Politike;

Për më shumë informacion mbi katalogun e kurseve referohuni linkut:

<https://www.usaintlouis.be/sl/3193.html>

Për katalogun e kurseve në gjuhën angleze referohuni linkut;

<https://www.usaintlouis.be/sl/984.html>

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor (850 EUR në muaj për studentët);

- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni link-ut:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifën e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Bachelor:

- CV (në gjuhën angleze/frënge);
- Kopje e Pasaportës;
- Foto elektronike;
- Vërtetim studenti (të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/frënge);
- Listë notash (të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/frënge);
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze/ frënge);
- Application form, sipas linkut:

https://www2.usaintlouis.be/public/international/2020-2021/registration_form_en-20-21.pdf

-Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht – Toefl, Ielts, Cambridge / Frengjisht – Delf, Dalf/ Certifikatë nga pedagogu i lëndës në fakultet);

-*Learning Agreement;

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin Saint Louis lëndë të njëjta me ato që do të kryeni në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin e dytë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvillohen lëndët që nuk përshtrahen në Universitetin e Tiranës.

Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset fillimisht nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe më pas në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +. Nëse studenti bën ndryshime të lëndëve gjatë mobilitetit, pjesa During mobility duhet të firmoset nga personi përgjegjës në fakultet dhe më pas nga personi përgjegjës në Rektorat.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement, sipas versionit të universitetit pritës, klikoni në adresën:

https://www.usaintlouis.be/fr/pdf/Erasmus/learning_agreement_in.pdf

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement, sipas versionit të UT, klikoni në adresën:

https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Learning_agreement_for_studies_Erasmus_outgoing-2-1.docx

- Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Ph.D.:

- CV + publikime (në gjuhën angleze/frënge);
- Foto elektronike;
- Vërtetim studenti (të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/frënge);
- Listë notash doktore + master (të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/frënge);
- Letër motivimi (në gjuhën angleze/frënge);
- Application form, sipas linkut:

https://www2.usaintlouis.be/public/international/2020-2021/registration_form_en-20-21.pdf

-Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht – Toefl, Ielts, Cambridge / Frëngjisht – Delf, Dalf/ Certifikatë nga pedagogu i lëndës në fakultet);

-*Learning Agreement;

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin Saint Louis lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin e dytë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvillohen lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.

Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset fillimisht nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe më pas në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +. Nëse studenti bën ndryshime të lëndëve gjatë mobilitetit, pjesa During mobility duhet të firmoset nga personi përgjegjës në fakultet dhe më pas nga personi përgjegjës në Rektorat.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement, sipas versionit të universitetit pritës, klikoni në adresën:

https://www.usaintlouis.be/fr/pdf/Erasmus/learning_agreement_in.pdf

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement, sipas versionit të UT, klikoni në adresën:

https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Learning_agreement_for_studies_Erasmus_outgoing-2-1.docx

Afati për aplikim: 13 Tetor 2020

Dokumentet duhen dorëzuar të skanuara në formatin PDF në adresën e-mail: iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al.

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikim!